



Presidentja e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 80 (3) dhe nenit 84 (6) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nxjerr:

V E N D I M

Për kthimin për rishqyrtim të Ligjit Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 31 tetor 2024, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës më 11 nëntor 2024.

A R S Y E T I M

Neni 84, paragrafi 6 i Kushtetutës përcakton se Presidentja e Republikës së Kosovës “*ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legititime të Republikës së Kosovës*”. Siç sqarohet edhe në Komentarin e Kushtetutës, ky nen nënkupton se Presidentja e Republikës gjëzon jo thjeshtë të drejtën e kontrollit të procedurës së ndjekur por edhe substancës së vet ligjit, përmes së cilit Presidentja e ushtron të drejtën për kontroll kushtetues të ligjeve.

Andaj, në mbështetje të nenit 84, paragrafi 6 të Kushtetutës, kam vendosur ta kthej për rishqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Me 31 tetor 2024, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar në lexim të dytë Ligjin Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit, i cili, *ndër të tjera* rregullon kushtet e tregut në marrëdhëni me biznes me konsumator dhe mekanizmat institucional për mbrojtjen e konsumatorit. Tutje, në nenin 4 (1.1) të Ligjit shprehimisht përcaktohet që ky Ligj ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit të konsumatorëve.

Sidoqoftë, nen 17, paragrafi 4 i Ligjit të miratuar nga Kuvendi pamundëson realizimin e qëllimit të synuar të Ligjit në raport me mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit të konsumatorit. Kjo sepse i njëjtë cënon mundësinë e zbatimit të obligimeve kushtetuese të institucioneve kompetente në fushën e mbrojtjes së mjedisit, pasi që kufizon aplikimin e masave të tjera, siç mund të ishte kalimi në paketimin më të qëndrueshëm dhe më miqësor për mjedisin.

Respektivisht, paragrafi 4 i nenit 17 të Ligjit krijon një standardizim të detyrueshëm të praktikave të përdorimit të qeseve plastike dhe e kufizon Qeverinë dhe ministrinë e Mjedisit që të ndërmarrin masa alternative që mund të lejojnë përdorimin e materialeve më të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, siç janë qeset e letres (eco-friendly) apo materialet tjera të biodegradueshme. Prandaj,

shpallja e Ligjit Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit do të krijonte konfuzion ligjor, si dhe do të shndërronte çdo politikë apo legislacion dytësor që promovon politika të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisit si akt në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve.

Si rrjedhojë, shpallja e këtij Ligji rrezikon drejtëpërdrejt interesat legitime të Republikës së Kosovës, dhe së dyti bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht me nenet 7 dhe 52 (3) të Kushtetutës.

Ligji bie në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 52 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe krijon kolizion ligjor me Ligjin përkates për mbeturina

Mbrojtja e mjedisit jetësor është një vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, e cila është e përcaktuar si e tillë në nenin 7 të Kushtetutës. Po ashtu, neni 52 (3) i Kushtetutës e obligon çdo institucion publik të marrë parasysh ndikimin në mjeshtësi gjatë procesit të marrjes së vendimeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për funksionimin e institucioneve që janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, si dhe për krijimin e mundësive të nevojshme për një menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave plastike.

Në këtë fryshtë, vlenë të theksohet se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimin në rastin KO43/19, ka obliguar Kuvendin e Republikës së Kosovës që gjatë nxjerrjes së ligjeve, të ketë parasysh fryshtë e Kushtetutës dhe fushëveprimin e institucioneve kushtetuese. Kësisoj, konsideroj se gjatë nxjerrjes së Ligjit Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka qenë i obliguar të ndjekë fryshtë e Kushtetutës dhe interesin legitim të vendit në raport me mbrojtjen e mjedisit jetësor si vlerë dhe kërkesë kushtetuese, në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, me përfshirjen e nenit 17 (4) në Ligjin Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit, Kuvendi rrezikon të krijojë një kufizim karshi masave alternative që mund të ndërmarrë për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike. Rrjedhimisht, rrezikon mundësinë e përmbytjes së obligimeve kushtetuese të institucioneve në raport me mbrojtjen e mjedisit, duke kufizuar mundësitë e tyre për rishikimin dhe përshtatjen e politikave që garantojnë mbrojtjen e mjedisit.

Për më tepër, neni 17, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit është në konflikt edhe me legjislativin ekzistues. Konkrektisht me Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i cili përcakton procedurat dhe masat për menaxhimin e ambalazhit dhe paketimit, përfshirë masat për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike. Ky ligj, në nenin 11, paragrafin 2 të tij, e ka mandatuar Qeverinë e Republikës së Kosovës me kompetencën për të nxjerrë akt nënligjor me të cilin përcakton kushtet, procedurat dhe detyrimet për prodhuesit dhe importuesit, duke krijuar mundësinë për të përcaktuar sisteme të tjera për menaxhimin e mbetjeve plastike, përfshirë një sistem të rimbursimit të depozitës.

Në këtë frysë, përfshirja e dispozitave të detajuara mbi qeset plastike në një ligj primar, siç është Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, krijon disa kufizime praktike dhe strukturore. Ligji primar ka një proces më të gjatë dhe më të komplikuar për ndryshimin dhe plotësim, krahasuar me një udhëzim administrativ. Si rezultat, Ligji përkatës për Mbeturina, ka paraparë mundësinë e nxjerrjes së aktit nënligjor, për të siguruar një mekanizëm të përditësimit të rregullave, sa herë që të jetë e nevojshme.

Për më tepër, vlenë të theksohet se Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit ka për qëllim kryesor mbrojtjen e konsumatorit përmes garantimit të transparencës së çmimeve, mbrojtjes nga praktikat tregtare të padrejta dhe sigurimit të produkteve të sigurta për përdorim, përderisa rregullimi i qeseve plastike, është kryesisht çështje e menaxhimit të mbeturinave dhe politikave mjedisore. Si e tillë, del jashtë qëllimit të këtij ligji. Si rezultat, vendosja e dispozitave të tilla në Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit krijon mbivendosje të panevojshme me legjislacionin ekzistues për mbeturinat, duke ngatëruar përgjegjësitë institucionale dhe duke rrezikuar efektivitetin e politikave.

Në rrjedhë të fakteve të lartcekura, shpallja dhe pastaj zbatimi i Ligjit Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit, në përbajtjen e miratuar, është kundër frysës së Kushtetutës e cila e trajton mbrojtjen e mjedisit si vlerë dhe si obligim. Njëkohësisht, Ligji me përbajtjen aktuale të tij, rrezikon të prishë ekuilibrin midis politikave të mbrojtjes së konsumatorit dhe atyre të menaxhimit të mbetjeve plastike, duke penguar avancimin e një sistemi ligor më të qëndrueshëm dhe më miqësor karshi mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe reduktimit të ndotjes plastike. Duke kufizuar mundësitë e institucioneve për të mbrojtur mjedisin, e si rrjedhojë për të mbrojtur edhe shëndetin e qytetarëve, cenohen interesat legitime të qytetarëve dhe të vet Republikës së Kosovës.

Pasojet e shpalljes së Ligjit Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit

Reziqet mjedisore, ekonomike dhe shëndetësore që paraqesin qeset plastike janë tashmë të njoitura dhe dëshmuara botërisht. Eliminimi i qeseve plastike nga tregu jo vetëm që i përshtatet përpjekjeve globale për qëndrueshmëri, por gjithashtu mbështet agjendën më të gjerë mjedisore për mbrojtjen e ekosistemave, reduktimin e ndotjes dhe përmirësimin e shëndetit publik.

Plastika është një material që, përvçe se ndotë, ka pasoja të rënda për ekosistemet dhe rrit nivelin e ndryshimeve klimatike. Kjo substancë, e cila shpesh mbetet në mjedis për një periudhë shumë të gjatë, është e dëmshme për biodiversitetin dhe mund të ndikojë rëndë në shëndetin e njeriut.

Qeset plastike janë të vështira për t'u ricikluar për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre. Sipas Komisionit European, më pak se 1% e qeseve plastike riciklohen në mënyrë efikase. Në shumë shtete, si edhe në rastin e Kosovës, qeset plastike përfundojnë në deponi, ku duhen shekuj të tërë për t'u dekompozuar dhe kontribuojnë në problemin në rritje të mbushjes së deponive. Prandaj,

studime të shumta kanë vërtetuar se reduktimi i përdorimit të plastikës është një hap i domosdoshëm për të përballuar kërcënimet që vijnë nga ndotja plastike dhe ndryshimet klimatike.

Në këtë drejtim, mungesa e qartësisë ligjore për përdorimin e qeseve plastike ndikon drejtpërdrejt edhe në përdorimin e tyre në mënyrë të pakontrolluar. Kjo rezulton në problem madhor mjedisor, meqë qeseve plastike mund t'ju duhen deri në 1,000 vjet për t'u dekompozuar në mjedis, duke lëshuar substancë tokësore në tokë dhe ujë ndërsa shkatërrohen, e rrjedhimisht duke dëmtuar jo vetëm shëndetin e brezave të tanishëm por edhe shumë brezave që do të vijnë pas nesh.

Qeset plastike, të prodhuara nga polietileni, shpesh përmbytjnë kimikate si ftalate dhe bisfenol A (BPA), të njohura si disruptorë të sistemit endokrin. Këto kimikate mund të kalojnë në ushqim dhe pijë, duke çuar në rreziqë të mundshme për shëndetin e njeriut. Studimet kanë treguar se eksposimi ndaj këtyre substancave mund të ndërhyjë në proceset riprodhuese dhe zhvillimore, dhe mund të lidhet gjithashtu me kancerin.

Si rezultat, Bashkimi Evropian e ka fuqizuar dhe plotësuar legjislacionin e nevojshëm në këtë fushë. Respektivisht, legjislacioni në fuqi që rregullon këtë fushë përbëhet nga: Direktiva (BE) 2019/904 për reduktimin e ndikimit të produkteve plastike të caktuara në mjedis, e cila kërkon që shtetet anëtare të miratojnë masa për të reduktuar konsumimin e qeseve plastike, veçanërisht ato me një trashësi më të vogël se 50 mikronë. Tësia, Direktiva (BE) 94/62 për Paketimin dhe Mbetjet e Paketimit, po ashtu kërkon nga shtetet anëtare të ndërmarrin masa për të reduktuar mbetjet e paketimit duke promovuar ri-përdorimin dhe riciklimin e paketimeve, përfshirë paketimet plastike si qeset plastike. Masat rigorozë për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike janë pjesë edhe e Marrëveshjes së Parosit për Ndryshime Klimatike dhe Paktit të Gjelbër Evropian. Rrjedhimisht, një ligj që kufizon mundësitë për prezantimin e politikave të qëndrueshme në këtë fushë është në kundërshtim edhe me legjislacionin e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në konteksttin e Republikës së Kosovës, ku menaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi janë ende në zhvillim, krijimi i mundësive për të ndaluar përdorimin e plastikës dhe promovimi i praktikave miqësore me mjedisin mbetet një hap i nevojshëm dhe urgjent. Ligji Nr. 08/L-288, përmes nenit nenit 17 (4) të tij, rrezikon të vështirësojë dhe ngadalësojë këtë proces.

Prandaj, përkundër rëndësisë së avancimit të kuadrit ligjor i cili siguron mbrojtjen e konsumatorit, Kuvendi i Republikës së Kosovës është i obliguar që të hartoje ligje të cilat janë në harmoni me Kushtetutën dhe legjislacionin horizontal. Përveç kësaj, standardet më të mira ndërkombëtare të ligjëbërjes, përcaktojnë se legjislacioni, *ndër të tjera*, duhet të jetë edhe i qëndrueshëm dhe konsistent [Komisioni i Venedikut, Lista e Kontrollit të Sundimit të Ligjit, fq. 26]. Për të evituar nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit menjëherë pas shpalljes, konsideroj se është më e arsyeshme që Ligji të rishikohet nga Kuvendi në këtë fazë.

Si përfundim, duke u bazuar në arsyetimin e këtij Vendimi, ia kthej Kuvendit të Republikës së Kosovës Ligjin Nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit me qëllim të rishqyrtimit të paragrafit 4 të nenit 17, për t'u siguar që i njëjtë të rishikohet me qëllim që të krijohet mundësia për ndërmarrjen e masave më të avancuara për mbrojtjen e mjedisit.

Kjo do të mundësojë mbrojtjen e një interesit legitim dhe të rëndësishëm për Republikën e Kosovës, atë të mjedisit jetësor dhe shëndetit të qytetarëve dhe do të kontribuonte në realizimin e obligimeve kushtetuese në këto dy fusha.

Me respekt,

Vjosa Osmani – Sadriu



Presidente e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 18. 11. 2024

Vendimi i dërgohet:

1. Kuvendit të Republikës së Kosovës;
2. a/a.